

7.04.2022  
Ora 12:20

**RENDI I DITËS**

Projektvendim “Për miratimin e rregullave për raportimin financiar të partive politike/subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”.

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

• **Komisioni Rregullator:**

- |            |           |                         |
|------------|-----------|-------------------------|
| • Ilirjana | NANO      | Kryetar                 |
| • Arens    | ÇELA      | Anëtar                  |
| • Dritan   | ÇAKA      | Anëtar                  |
| • Helga    | VUKAJ     | Anëtar                  |
| • Muharrem | ÇAKAJ     | Anëtar                  |
| • Stafi    | KQZ       | Y. Merkaj, V. Ballgjini |
| Parti      | Politike: | PDIU, PL, LZHK          |
| Të         | tjerë:    | KRIIK                   |

**Znj. I. Nano:** Mirëdita! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, Sekretari i Përgjithshëm dhe zyrtarë të tjerë të administratës, përfaqësues të subjekteve zgjedhore dhe të shoqërisë civile. Zoti Sekretar i Përgjithshëm, nga përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore dy prej tyre janë të njohur për ne, dakord, përfaqësuese e akredituar në KQZ. Mirë, në mbledhjen e sotme kemi në rendin e ditës për tu shqyrtuar një projektvendim “Për miratimin e

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 7.04.2022*

rregullave për raportimin financiar të partive politike/subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Ky projekt ka ardhur me propozim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, kështu që do t'i lutesha Sekretarit të Përgjithshëm të bëjë një paraqitje të përmbledhur të projektaktit dhe relacionit shpjegues.

**Z. Y. Merkaj:** Faleminderit, relatimin do ta bëjë drejtoresha e auditit.

**Znj. I. Nano:** Zonja Ballgjini, po.

**Znj. V. Ballgjini:** Relacioni lidhur me projektvendim “Për miratimin e rregullave për raportimin financiar të partive politike/subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Në fakt ky është një vendim i cili është miratuar, nuk është një vendim i ri le të themi, por ka qënë i miratuar në zgjedhjet e 2021-shit, pati një miratim të vendimit në zgjedhjet e pjeshme të vitit 2022, dhe tani vjen i rishikuar me risi, me formate të standartizuara për projektraportin e auditimit, i cili rishikohet në mënyrë të tillë që audituesit përveç se të përpilojnë një raport përfundimtar, përpara përpilimit të raportit përfundimtar, të ketë një raport paraprak, pra partitë politike/subjektet zgjedhore të njihen paraprakisht me gjetjet nga auditimi, të kenë mënyrë për t’u njohur dhe për të kthyer përgjigje dhe më pas të konkludohet me një raport përfundimtar. Është raportimi online i formateve financiare për fushatën zgjedhore, pra platforma elektronike e raportimit financiar, është dhënë si një mundësi ekstra, pra një mundësi e shtuar për mënyrën e raportimit financiar, si nga ana e subjekteve zgjedhore ashtu edhe nga kandidatët. Raportet financiare, raportet e auditimit do të jenë pjesë pra e kësaj platforme, detyrimet dhe përgjegjësitë e dorëzimit të raportit financiar për

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 7.04.2022*

kandidatët në rastet kur propozohen nga koalicioni, dhe përgjegjësitë e kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit si dhe një risi tjetër në këtë projektakt është edhe, le të themi, mos të kenë të detyruar partitë politike/subjektet zgjedhore që të përfaqësohen me kandidatë të listave shumemërore edhe nga financierët e partive politike, duke qënë se ka qënë një detyrim i vendimit të vjetër. Për mendim, ju lutem, doja të shtoja këtu në fakt, përpara se sa të kalojmë për votim të aktit, rreth gjysmë ore përpara fillimit të seancës, jemi vënë në dije me një email të ardhur nga organizata KRIIK, lidhur me disa sygjerime që organizata KRIIK ka sjell për aktin, ju a kam bërë me dije edhe anëtarëve të Komisionit Rregullator, nuk e di nëse do kemi sugjerime nga organizata apo mendime të tjera. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Po, edhe ne para pak jemi njohur me email me disa rekomandime, të cilat na kanë ardhur dhe nga ana juaj, në fakt kur të vijë momenti ta diskutojmë në parim dhe nen për nen, nëse do të kenë kolegët diçka, apo nëse nga vet përfaqësuesit e organizatës që janë të pranishëm. Mirë, atëhere kolegë fillojmë me diskutimin në parim të projektvendimit, kemi diçka në parim? Jo! Atëhere votojmë në parim projektvendimin.

***Kush është dakord?***

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet! Kalojmë në shqyrtimin nen për nen, duke qënë që bëhet fjalë për një akt shumë voliminoz, me kërkesë por dhe dakortësi të anëtarëve, unë nuk do të lexoj përmbajtjen e secilit nen, pra do të votojmë nenin, do të shqyrtojmë, diskutojmë, propozojmë shtesa, ndryshime por pa e lexuar përmbajtjen e neneve, është një akt që iu është vënë në dispozicion dhe subjekteve politike, madje në periudhën e konsultimit, edhe më herët të këtij akti para se të dërgohej zyrtarisht para dy ditësh. Fillojmë me nenin 1, zoti Çakaj, po!

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 7.04.2022*

**Z. M. Çakaj:** Atëhere përpara se të fillojmë me diskutimet nen për nen, ashtu siç relatoi dhe drejtoresha e auditit, zonja Ballgjini, ne jemi njohur mos gaboj diçka përpara mos gaboj, gjysmë ore, një orë përpara zhvillimit të kësaj mbledhjeje, me disa, me një email nga organizata KRIIK, ku janë parashtruar disa rekomandime lidhur me këtë projektvendim. Nga një vështrim i përgjithshëm që i kemi bërë këtij emaili, të paktën unë personalisht konstatoj që lidhur me disa nga këto sygjerime kanë të bëjnë më së shumti, më së shumti i takojnë mënyrës së organizimit dhe mënyrës së financimit të partive politike, dhe duke qënë se edhe nga aktorët politik po diskutohet që të bëhet një organizim dhe një ligj i ri për partitë politike, unë besoj se këto rekomandime dhe këto propozime mund të gjejnë më mirë vend në ligjin e ri që do të miratohet për partitë politike. Disa rekomandime të tjera, kanë të bëjnë më, të paktën është propozuar mundësi i përpunimit të panvarur të të gjitha të dhënave të raportuara, prat ë dhënave financiare të raportuara nga partitë politike. Sjell në vëmëndje të përfaqësueses KRIIK që ligjvënësi në Kodin Zgjedhor ja ka ngarkuar qoftë mënyrën e organizimit, nxjerrjen e akteve nënligjore, përpunimin e të dhënave, auditimin e fondeve, ja kanë ngarkuar ekskluzivisht Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nga ana tjetër i ka ngarkuar dhe një detyrim Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e cila është transparenca. Besoj dhe me miratimin e këtij akti me platformën elektronike, tashmë gjithçka do të jetë transparente dhe besoj arrihet dhe ky qëllim që ka dashur me rekomandimin e vet të propozojë organizata KRIIK. Ka dhe disa propozime të tjera të cilat janë të karakterit teknik, dhe besoj për këto do doja një mendim më të specializuar nga zonja Ballgjini. Gjithashtu doja, duke e vlerësuar bashkëpunimin dhe komunikimin deri tani me organizatën KRIIK, mora informacion se ky projektakt i është dërguar, të paktën ka ca kohë që i është dërguar për njohje të gjithë aktorëve, partive politike dhe organizatës dhe do të sygjeroja, do të vlerësoja nëse do të kishim propozime, rekomandime jo në momentin e fundit, por diçka kohë përpara në mënyrë që edhe ne të kemi kohën

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 7.04.2022*

e duhur t'i shqyrtojmë, t'i diskutojmë, t'i analizojmë dhe pse jo çfarë gjejmë me vend edhe ta pranojmë. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Po, zonja Ballgjini.

**Znj. V. Ballgjini:** Lidhur me sygjerimet e organizatës KRIIK, në fakt për pjesën e parë të sygjerimeve që ishin lidhur me aktin, zoti Çakaj dha përgjigjet e tij, unë do doja të ndalesha për pjesën e shtojcave, duke qënë se janë voluminoze edhe sygjerimet e KRIIK-ut, në fromatet e raportimit dhe një nga sygjerimit është emaili ku duhet dërguar raportimi financiar. Është vënë një email me person përgjegjës duke qënë thjesht dhe për t'u identifikuar emaili ku shkon, nuk është vënë një email përgjithësues dhe pastaj të themi ka ardhur, s'ka ardhur, apo s'ka ardhur në kohë. Thjeshtë dhe vetëm për çështje kohe dhe për përgjegjshmëri për personin përgjegjës i cili i merr, kështu që nuk mendoj se ka ndonjë problem të jetë person përgjegjës, apo ndoshta hapim dhe krijojmë dhe një email tjetër që të jetë thjeshtë dhe vetëm për pjesën e financimit dhe të shkojë te emaili përgjithësues. Për pjesën e formateve exel zoti Çakaj e përmendi, formatet exel do jenë, është thënë edhe në lançimin e platformës tre ditë përpara që platforma do të mundësojë edhe përpunimin e të dhënave, pra do të ketë formate të asaj natyre, të cilat do të mund të jenë lehtësisht të aksesueshme nga organizatat apo nga vet publiku i gjërë. Përsa i përket raportimit të të ardhurave në sesionin 2b siç është i miratuar në shtojcën nr 1, 2 dhe 3, pra për raportimin e partisë politike, kandidatëve dhe kandidateve të miratuar nga zgjedhësit, organizata KRIIK kërkon që kategoritë e të ardhurave të jenë të, të përfshihen ra, të ketë disa kategori, në mënyrë të tillë që financierët të përzgjedhin, kjo në platformën elektronike të raportimit financiar është bërë e mundur, pra në momentin që kjo platform do të jetë në dispozicion të partive politike dhe kandidatëve ata do mund të zgjedhin dhe të deklarojnë le të themi, të ardhurat e tyre duke pasur këto

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 7.04.2022*

kategori. Përsa i takon, për pjesën e identifikimit të dhuruesëve, pra nëse janë persona fizik apo juridik, organizata KRIIK kërkon që të jetë përveç numrit të identifikimit, pra numri i identifikimit të jetë edhe Nipt, për ne nuk ka asnjë problem, mund të bëhet, thjeshtë është lënë numri i identifikimit, se nëse ne themi se është person fizik, person juridik i cili është i pajisur me Nipt, numri i identifikimit është nipt-i, por nuk përbën asnjë lloj problem që mund të bëhet me një slash, nr. identifikimi/ ID/Nipt. Financimet jopublike, flasim gjithmonë për sesionin e të ardhurave, në kolonat n dhe o kesh duhet të deklarohet emëri i marrësit në dorëzim për shumë përkatëse. Ne e kemi një deklaram pra, ne themi kush e merr kesh, e merr selia qendrore, apo e marrin selitë rajonale të partive. Me sa arrijë të, sepse ju thashë që koha është edhe e shkurtër dhe unë nuk kam pasur kohë dhe mundësi që të ulem dhe ta shikojë në detaje, kërkesat e organizatës. Kërkohet që personi përgjegjës pra, personi i cili e ka marr në dorëzim këtë dhurim pra, nga selia, apo kur janë të ardhurat kesh. Në seksionin 2, c, të ardhura dhurime në natyrë duhet të përmbajnë në kolonën e parë një kategorizim të llojeve të tij, ky kategorizim do të mundësohet gjithashtu në platformën elektronike, pra është bërë një farë kategorizimi, për sa ne arrijmë të bëjmë një parashikim të mundshëm të llojeve të dhurimeve dhe për pjesën që mund të ketë të tjera është lënë një opsion, le të themi, të tjera dhe mund të citohet në komentet që mund të kenë partitë politike.

**Znj. I. Nano:** Dakord, zonja Ballgjini, ndjesë, sigurisht që jemi të ndërgjegjshëm, besoj dhe vetë organizata që i ka dërguar këto rekomandime janë të ndërgjegjshëm për kohën e shkurtër të cilën na kanë vënë në dispozicion dhe që mundësia për t'i shqyrtuar një nga një të gjitha sot është e pamundur, madje nuk është detyrimi i Komisionit Rregullator t'i shqyrtojë në mbledhje propozimet e organizatave, propozimet e subjekteve zgjedhore padyshim, prandaj edhe organizatave u dërgohet më herët për konsultim që t'i dërgojnë rekomandimet e

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 7.04.2022*

tyre para se drafti të konsolidohet dhe të vijë zyrtarisht. Në çdo rast, unë mendoj që ne të vijojmë me shqyrtimin e aktit sot, ju, por dhe ne, t'i shihni me vëmendje dhe nëse do të vlerësoni që të bëni propozime bazuar në rekomandimet e KRIIK-ut, për ndryshime të mundshme të aktit që ne po shqyrtojmë dhe do të miratojmë sot, patjetër që ne mund të rimblidhemi, mund ta mendojmë aktin, mund të bëjmë ndryshimet e duhura, por në çdo rast vlerësoj që miratimi i këtij akti, në këtë moment, në këtë kohë, është doemosdoshmëri, sepse fushata zgjedhore fillon shumë shpejt, ju si administratë keni planifikimet tuaja lidhur me trajnimet e financierëve të partive politike, prandaj unë do të kërkoja të merrnit kohën tuaj për të bërë vlerësimet, ndoshta dhe në bashkëpunim me organizatën, apo dhe nëse do të na vijnë apo kanë ardhur edhe sygjerime të tjera. Kanë ardhur sygjerime të tjera nga organizata apo nga subjekte zgjedhore me shkrim, zoti Sekretar i Përgjithshëm?

**Z. Y. Merkaj:** Jo nuk kanë ardhur.

**Znj. I. Nano:** Nuk kanë ardhur, dakord! Meqë kemi këto, mund t'i shihni nëse do të vlerësohet ndonjë prej tyre për ta propozuar për ndryshim, por edhe ne nga ana tjetër, sepse edhe ne jemi njohur me këto sygjerime, dhe ne si anëtarë të Rregullatorit do t'i shohim, për të parë nëse mund të bëjmë ndryshime në ditët e ardhëshme, qoftë edhe pa filluar fushata zgjedhore, fushata elektorale. Faleminderit zonja Ballgjini, fillojmë atëhere shqyrtimin nen për nen, sikundër ju thashë, për shkak të volumit të madh të projektvendimit, ku përfshihen teksiti i projektvendimit dhe shtojcat, unë nuk do t'i lexoj një për një. Neni 1 është "Objekti", ky vendim ka për objekt përcaktimin e rregullave për raportimin financiar për fushatën zgjedhore, të subjekteve zgjedhore, kandidatë të listave sumemërore, kandidatë për kryetar bashkie, kandidatë e propozuar për zgjedhjet, monitorim, mbikqyrje dhe auditim i të ardhurave, shpenzimeve, miratimin e

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



modeleve të dokumentacionit që duhet të përdoret me këtë rast. Kemi diçka për neni 1? Kalojmë në votimin e nenit 1.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet! Kalojmë te neni, "Raporti financiar për fushatën zgjedhore". Kemi diçka për informacionin që duhet të përmbajë raporti financiar i fushatës zgjedhore, kolegë? Votojmë atëhere nenin 2.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet! Neni 3, "Dorëzimi i raportit financiar për fushatën zgjedhore", kuptohet ka nevojë edhe për pak redaktim në përfundim. Dorëzimi i raportit lidhet me detyrimet, me afatet brënda të cilave duhen dorëzuar raportet, me mundësimin e platformës elektronike të raportimit financiar, me publikimin në faqen zyrtare të internetit dhe në faqet e partive politike.

**Kolegë, kush është dakord me nenin 3?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka

Miratohet, me 5 vota pro! Neni 4, "Vlerësimi i prima facie i raportit financiar të fushatës zgjedhore nga KQZ-ja", padyshim ky është një nen i gjatë që përfshin edhe auditimin, nga ana e audituesëve ligjor, kështu që personalisht ndoshta do të, dakord, ndjesë, "Vlerësimi i prima facie i raportit financiar të fushatës zgjedhore nga KQZ-ja". Kolegë, keni diçka për nenin 4? Jo! Kalojmë në votimin e nenit 4.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 7.04.2022*

Me 5 vota pro, miratohet! Neni 5, “Auditimi i raportit financiar të fushatës zgjedhore”, pikërisht ky është ai neni i gjatë që sa po thoja. Po zonja Vukaj, kishit diçka?

**Znj. H. Vukaj:** Në funksion të një mbarvajtjeje të kontrolluar, apo të rregulluar më mirë do të thoja, meqënëse audituesi ligjor me një farë mënyre merr tagrat e, ose i autorizohen disa prej tagrave të KQZ-së në këtë drejtim, do të sygjeroja, apo të propozoja që në pikën 3 të shtonim: ‘audituesi ligjor, në bazë të parimeve të auditimit, ka të drejtë të’, pra mos të ishte thjeshtë ‘audituesi ligjor ka të drejtë’ por ‘në bazë të parimeve të auditimit’, ashtu siç ndodh në procesin e punës që ata shpalosin, por në të njëjtën kohë e kanë edhe detyrim jo vetëm ligjor por edhe profesional, thjeshtë ta vendosim për të qënë vizuale.

**Znj. I. Nano:** Ndonjë propozim tjetër për nenin 5? Pra është neni 5, pika 3. Kemi propozim tjetër për nenin 5? Jo! Atëhere votojmë propozimin e zonjës Vukaj.

**Kush është dakord me shtesën e propozuar nga zonja Vukaj?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S’ka

Me 5 vota pro, miratohet! Neni 6, “Verifikimi dhe kontrolli i raporteve financiare të fushatës zgjedhore, të subjekteve zgjedhore, dhe krahasimet me raportet e auditimit”, është neni përkatës, që parashikon edhe riauditimin e mundshëm, në rast të mospërputhshmërive mes raporteve dhe, krahasimit mes raporteve, raportit të partisë dhe raportit të përgatitur nga audituesi ligjor. Pra është mundësia e një riauditimi, përpara se KQZ-ja të hartojë dhe të vlerësojë gjetjet.

**Kolegë, kush është dakord me nenin 6?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S’ka

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



Me 5 vota pro, miratohet! Neni 7, “Financieri i partisë politike dhe përgjegjësitë e tij”, kemi diçka? Jo! Kalojmë në votimin e nenit 7.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S’ka

Miratohet, me 5 vota pro! Neni 8, “Përgjegjësitë e kandidatëve të listave shumemërore dhe kandidatëve për kryetar bashkie të propozuar nga partia politike, koalicioni”, padyshim kjo është një nga situatat ku në zgjedhje paraqiten ose partitë politike veçmas, ose në kuadër të një koalicioni, dhe janë përcaktuar përgjegjësitë konkrete të kandidatëve. Me neni 8 kolegë, kemi diçka? Nëse jo, kalojmë në votimin e nenit 8.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S’ka

Miratohet, me 5 vota pro! Neni 9, “Përgjegjësitë e kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit”, sigurisht janë veçuar ky grup kandidatësh, për shkak se përgjegjësia ligjore bie drejtëpërdrejtë mbi ta, dhe nuk kanë detyrimin e marrjes së një financieri, është çështje opsionale, nëse dëshirojnë të angazhojnë një financier për të përgatitur raportet. Kemi ndonjë diskutim lidhur me nenin 9? Jo! Kalojmë në votimin e nenit 9.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S’ka

Me 5 vota pro, miratohet! Neni 10, “Shfuqizimet”, vendimi nr. 9, datë 29.1.2022, i Komisionit Rregullator, për përcaktimin e rregullave, për raportimin financiar të partive politike, subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, shfuqizohet.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka

Miratohet, me 5 vota pro! Neni 11, "Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve".

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka

Miratohet, me 5 vota pro! Neni 12, "Ankimi", kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Kolegjin Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi, po zonja Vukaj.

**Znj. H. Vukaj:** Kemi standartin e ngritur tashmë, ngarkohet ai seksion apo ai sektor i administratës, ose administrata përgjithësisht, për zbatimin e atij akti. Kështu që nuk po e bëjmë propozim, por thjeshtë të shtohet.

**Znj. I. Nano:** Po, atëhere votojmë nenin 12, "Ankimi".

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet! Meqënëse e kemi miratuar në parim dhe nen për nen vendimin, kalojmë në votimin në tërësi të tij, edhe njëherë kolegë, dakortësinë tuaj.

**Kush është dakord me projektvendimin në tërësi?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet! Sikundër thamë në diskutimet në fillim të mbledhjes, do t'i luteshim administratës dhe drejtorisë përkatëse, të bënin një vlerësim të

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 7.04.2022*

sygjerimeve të ardhura dhe të na vijnë në formën e një propozimi nëse do ta gjeni me vënd, ndërkohë dhe ne nga ana jonë do t'i vlerësojmë ato. Duke qënë që nuk kemi çështje tjetër për shqyrtim në rendin e ditës, mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Faleminderit!

**Vendimi nr. 15**

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*

